

*Nexhat Maloku
Rifat Hamiti*

UNË DHE TË TJERËT

Për nivelin
e parë

EMRI DHE MBIEMRI:

KLASA

SHKOLLA


VENDI


SHTETI

duk²gjini

ISBN 978-9951-05-233-1
3900489290206

A B C Ç D D H E E F G J Q H I K L N M U L L N J O P A R R S H T H U V X Y Z Z H





Nexhat Maloku, Rifat Hamiti

Unë dhe të tjerët

Fletore tematike
për nivelin e parë

duk^ə_Dgjini

MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGjisë E KOSOVËS

TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku, Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Nexhat Maloku, Rifat Hamiti

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut (Instituti IPE -International Projects in Education) dhe Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.

PH Zürich




**LOTTERIEFONDS
KANTON ZÜRICH**

PËRMBAJTJA

1. Kush jam unë.....	5
2. Dita e parë e shkollës	8
3. Në pushimet verore.....	10
4. Atdheu im.....	12
5. Unë dhe të tjërët.....	14
6. Familja e Albanës	16
7. Familja dhe farefisi.....	18
8. Një ditë në shtëpinë tonë.....	20
9. Banesa jonë	22
10. Shkolla jonë	24
11. Në klasën e shkollës shqipe.....	26
12. Shtatë motrat.....	28
13. Unë u ndihmoj prindërve	30
14. Festat e fundvitit.....	32
15. Ditëlindja	34
16. Kërkimi i faljes.....	36
17. Vajzat luajnë futboll	38
18. Qetësi	40
19. Shoqja ime Stela	42
20. Mes dy vendeve	44





Kush jam unë!

Unë quhem Arlind Anamali.

Më pëlqen të pi lëng molle.

Më pëlqen të ha picë.

Në shkollë lexoj me dëshirë.

Dëshiroj të luaj me Albanin.

Prej kafshëve më shumë
e dua macën.

Unë di të ngas bicikletën.

Hobi im është futbolli.

1.) Si dukesh?

Shiko veten në pasqyrë dhe vizato!

Ky jam unë: _____
(Emri e mbiemri)

2.) Përgjigju me shkrim

Sa vjeçar je? _____

Çka pi me dëshirë? _____

Po çka han ti me kënaqësi? _____

Çka nuk të pëlqen të hash? _____

Çka bën me kënaqësi në shkollë? _____

Me kë dëshiron të luash? _____

Cilën kafshë e do më shumë? _____

A di të ngasësh bicikletën? _____

Cili është hobbyt? _____

3.) Shiko vizatimin e shokut/shoqes. Ku dallon ti prej tij/saj? Së pari tre-goji mësuesit/mësueses e pastaj shkruaj në fletore. (Të paktën 4 fjali!).

P.sh. Unë kam sy të _____, kurse shoku im/shoqja ime ka
sy të _____



Dita e parë e shkollës

Në mesditë u ktheva nga mësimi i paradites. Nëna më priti e buzëqeshur. Ajo më përkëdheli me dashuri.

- Me fat vitin e ri shkollor, biri i nënës! - më tha.
- Faleminderit, nënë! – iu përgjigja.
- Genti, sot ke edhe gjuhë shqipe, - më tha ajo.
- Po nënë, e di, çantën e kam bërë gati që mbrëmë.

Isha shumë i gjëzuar. Do ta takoja mësuesin e gjuhës shqipe dhe shokët e shoqet e klasës. Secili do të tregojë ku dhe si i ka kaluar pushimet verore.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

më përkëdheli - më lëmoi flokët

që mbrëmë - dje në mbrëmje

1.) Mësoje përmendsh këtë strofë vjershe

Pa shihni ç'gjuhë e mirë!

Sa shije ka e hije!

Ç'e e bukur dhe e lirë,

Si gjuhë Perëndije!

Naim Frashëri

SHKOLLA ËSHTË BURIM I DIJES

2.) Përgjigju pyetjeve së pari me gojë e pastaj edhe me shkrim

- Për cilën ditë bëhet fjalë në këtë pjesë leximi? _____

- Nga po kthehej Genti? _____

- Kush e priste atë në shtëpi? _____

- Çka i përkujtoi nëna Gentit? _____

- Për çfarë do të bisedojnë shokët e shoqet e klasës shqipe? _____

- Cilat pushime kaluan? _____

- Kush i fton nxënësit për mësim? _____

- Si do të fillojë mësimi? _____

3.) Shkruaj se cilat janë pushimet shkollore gjatë vitit

Në gjuhën shqipe

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

Në gjuhën e vendit ku jeton ti

4.) Shkruaj disa fjali për ditën tënde të parë në shkollë



Në pushimet verore

Filloi viti i ri shkollor. Mësuesja na priti me gëzim në oborrin e shkollës. Hymë në klasë dhe u ulëm nëpër vendet tona. Filloi biseda.

- Mësuesja:** – Të dashur nxënës. Mirë se erdhët në shkollë!
Të gjithë qenkeni të gëzuar. Pushimet si i kaluat?
- Fatmirja:** – Unë kam qenë në plazhin e Durrësit. Atje njoha shumë shoqe e shokë nga të gjitha pjesët e Atdheut.
- Liridoni:** – Unë këtë vit isha në Brezovicë. Në këtë pushimore kishte turistë nga shumë vende.
- Pranvera:** – Unë isha te tezja në fshat. Në kopsht kishte qershi, mollë e dardha plot. Pashë edhe qenin e Sharrit, kalin, lopë e shumë dele.
- Artani:** – Unë isha ke halla në Strugë. Çdo ditë me kushërinjtë e kushërirat e mia dilnim për t'u larë e për t'u rrezitur në brigjet e liqenit.
- Besa:** – Këtë vit unë isha te daja në Amerikë. Në dasmën e tij vallëzuam e kënduam për disa ditë me të afërmët tanë.

1.) Lexojeni tekstin sipas rolevë.

2.) Shkruaj se ku kanë qenë fëmijët në pushime

Fatmirja: _____

Liridoni: _____


Pranvera: _____

Artani: _____

Besa: _____

3.) Shkruaj: Ku, me kë dhe si i kalove pushimet verore? _____

4.) Vizato këtu diçka të bukur nga pushimet e tua!



Atdheu im

Pas leximit të një tregimi, mësuesi më pyeti:

- Arbër, a e kupton ti fjalën atdhe?
- Jo mësues, por kushëriri im e ka emrin Atdhe,- thashë unë.
- Paska emër të bukur, por kjo fjalë ka një kuptim, - tha ai.
- Nuk e di mësues,- u përgjigja unë.
- Nga është familja jote?- vazhdoi mësuesi.
- Nga Gjilani,- ia ktheva.
- Pra, ata janë nga Kosova,- tha ai.
- Po mësues, ashtu është,- thashë unë.
- Fjala atdhe ka kuptimin e vendit prej nga është familja jote,-tha ai.

Mësuesi na tregoi se atdheu është vendi ku kanë lindur prindërit tanë, ku banojnë shqiptarët. Ndryshe quhet edhe mëmëdhe.

U gëzova që mësova kuptimin e kësaj fjale. Kur shkova në banesë, vizatova shtëpinë tonë në Kosovë. Mbi të shkrova: Atdheu im.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

atdheu – vendi ku kemi lindur a jetojmë ne, vendi ku jeton populli ynë.

mëmëdheu - fjalë e njëjtë me fjalën atdhe.

kushëriri – djali i xhaxhait, i hallës a i tezes, i afërm

Pyetje për tekstin

1. Çfarë e pyeti mësuesi Arbrin? _____
2. Si u përgjigj ai? _____
3. Prej nga vjen familja e Arbit? _____
4. Çfarë kuptimi ka fjala atdhe? _____

1.) Përktheji në gjuhën e vendit ku jeton këto fjalë:

Atdheu _____ Prindërit _____
Shtëpia _____ Kusheriri _____

2.) Plotëso tekstin

Atdheu im është _____. Familja ime është nga _____.
Unë e dua atdheun tim, sepse _____. Për pushimet e
_____ unë do të shkoj në _____.
Unë me familjen time do të udhëtojmë me _____.

3.) Krahaso!



Ky është një _____ Ky është një _____

Cilat janë dallimet mes fshatit dhe qytetit? _____

4.) Shkruaj disa fjali për fshatin apo qytetin ku jeton tash:

Fjalë e urtë Duaje atdhenë si shqiponja folenë!



Hasan Nallbani:
Djemtë e rrugës

Unë dhe të tjerët

Unë quhem Gëzim. Jam tetëvjeçar. Jam nga Kosova. Ne klasën time ka disa nxënës që janë nga vende të ndryshme të botës. Unë kam flokë të shkurtër. Disa të tjerë kanë flokë të gjatë ose kaçurrel. Unë vesh rroba që më pëlqejnë. Ashtu bëjnë edhe të tjerët. Unë mësoj mirë dhe i ndihmoj shokët e shoqet e mia. Mua më pëlqen futbolli. Kurse shoqja ime Ana luan në piano. Unë flas shqip, Martini flet anglisht, kurse Antonio flet italisht. Unë mendoj që është shumë bukur që jemi kështu të ndryshëm. Unë dëshiroj që gjithkund në tokë të ketë paqë. Atëherë ne fëmijët do të rritemi me gëzim në familjet tona.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

rroba – veshjet e njerëzve

paqe – gjendje e qetë, pa luftë në një vend

1.) Përgjigju pyetjeve (me gojë, së bashku me një shok/shoqe)!

1. Çfarë nxënësish ka në klasë?
2. Çfarë i pëlqen Gëzimit?
3. Çfarë gjuhe flasin shokët e Gëzimit?
4. Çka deshiron Gezimi?
5. Kur do të rriten fëmijët me gëzim?

2.) Përgjigju me shkrim pyetjeve të mëposhtme

1. Çfarë ngjyre të lëkurës kanë njerëzit? _____
2. Shëno disa gjuhë që i flasin popujt e ndryshëm? _____
3. Çfarë lojërash luajnë njerëzit? _____
5. Cilat religjione i njeh ti? _____
6. Çka di për paqen në botë? _____

3.) Përkthe në gjuhën e vendit ku ti jeton këto fjalë:

Tokë _____ veshje _____
gjuhë _____ paqe _____

4.) Shkruaj një tekst të vogël
për veten tënde _____

5.) Ngjyros globin





Në familjen e Albanës

Familja ime jeton në mërgim. Ne kemi ardhur këtu para shumë vjetësh. Në fillim ishte vështirë, por tash jemi mësuar. Ne kemi njobur disa familje vendëse, si dhe shqiptarë nga Shqipëria, Kosova e Maqedonia. Edhe ata jetojnë këtu.

Mua më merr malli për familjen e gjerë në Kosovë. Sidomos për dy kush-ërirat e mia, Arlindën dhe Blertën. Mezi pres të vijnë pushimet e verës e të shkoj t'i vizitoj të gjithë.

Unë kam mjaft shoqe e shokë në shkollë. Me ta luaj gjatë kohës së lirë. Mua më pëlqen të jetoj këtu. Në fundjavë dalim me nënën dhe babanë në shëtitje.

Kurse vëllai im Iliri luan me shokët e tij futboll. Kur vijmë në shtëpi, Iliri dhe unë përgatitim sendet për shkollen.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

mërgim – vend i huaj ku jeton dikush

vendës - banor i një vendi që është lindur e rritur aty

më merr malli - dëshirë e fortë për ta parë dikë

1.) Vizato anëtarët e familjes sate!

2.) Anëtarët e familjes sime janë:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

5. _____
6. _____
7. _____
8. _____

3.) Fqinjët e mi janë:

1. _____
2. _____

3. _____
4. _____

Unë kam këta të afërm në atdhe: _____

4.) Plotëso tekstin e mëposhtëm

Unë banoj në _____.

Unë kam ardhur nga _____.

Shoqet e mia/ shokët e mi janë _____
_____.

Shkolla ime e ka emrin _____. Mësuesi/ja im/e quhet _____.

5.) Diskutojini pyetjet vijuese, pastaj shkruani

Kur ka ardhur familja jote në mërgim dhe pse?

A të pëlqen të jetosh këtu dhe pse?



Familja dhe farefisi

Në një shesh me lodra po luanin dy djem. Pranë tyre kaloi një plak. Kur i dëgjoi duke folur shqip, u ndal dhe i pyeti:

- Çka e keni njëri-tjetrin?
- Vëllezër, – u përgjigj më i madhi.
- Si quheni? – pyeti plaku.
- Unë quhem Kushtrim, kurse unë Atdhe – u përgjigjën secili për vete.
- Po prindërit ku i keni? – vazhdoi plaku.
- Babai është në punë, kurse nëna në shtëpi. Ajo kujdeset për motrën e vëllanë, që janë binjak, – u përgjigj Kushtrimi.
- Po nga farefisi kë keni?- pyeti plaku.
- Kemi gjyshin dhe gjyshen nga babai e nga nëna, – u përgjigj Atdheu.
- Kemi edhe xhaxhanë, hallën, dajën, tezen e shumë kushërinj e kushërrira. Disa jetojnë në atdhe, disa në Gjermani, Zvicër, Austri, Suedi, Belgjikë dhe në Amerikë, – u përgjigj Kushtrimi.
- Ju faleminderit dhe ditën e mirë, fëmijë të dashur! – përshëndeti plaku.
- Mirupafshim, xhaxha! - u përgjigjën të dy njëzëri.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

si quheni - si e keni emrin
binjak - janë lindur përnjëherësh nga e njëjta nënë
njëzëri - së bashku, përnjëherësh

T'i shtojmë njohuritë:

- Prindërit, vëllezërit dhe motrat janë familja e ngushtë.
- Familja e ngushtë plus gjyshërit, gjyshet, xhaxha e halla janë familja e gjerë.
- Daja, tezja, fëmijët e tyre e fëmijët e xhaxhait dhe të hallës janë farefis.

1.) Shkruani në vija fjalën që duhet.

1. Nëna ime dhe babai im janë _____ e mi.
2. Nëna e nënës sime është _____ ime.
3. Babai i babait tim është _____ im.
4. Motra e nënës sime është _____ ime.
5. Vëllai i babait tim është _____ im.
6. Motra e babait tim është _____ ime.
7. Vëllai i nënës sime është _____ im.
9. Prindërit e mi mua më kanë _____.
10. Kurse motrën/vëllain _____.
11. Gjyshi dhe gjyshja mua më kanë _____.
12. Kurse vëllain/motrën _____.
13. Nëna, babai, vëllai dhe motra ime janë _____ ime.
14. Xhaxhallarët, tezet, hallat janë _____ im.

2.) Mësoni ta lexoni bukur poezinë:

Mysafirët

Mirë se na erdhe, teze,
porsi hëna me rreze!

Mirë se na erdhe, gjyshe,
gushë – dallëndyshe!

Mirë se na erdhe, dajë,
si ylli në majë!

Mirë se na erdhe, kushërirë,
Porsi embëlsirë!

Mirë se na erdhe, hallë,
Mysafirë i rrallë!

Sa herë e hapni këtë derë,
Dimri bëhet verë.

RIFAT KUKAJ

3.) Me cilat fjalë i lavdëron poeti mysafirët?

Teze

Gjyshe


Dajë

Hallë

Kushërirë

Një ditë në shtëpinë tonë

Unë banoj së bashku me nënën, babanë, motrën, dy vëllezër, gjyshin dhe gjyshen. Një ditë te ne erdhën mysafirë tezja dhe daja. Secili prej nesh bënte diçka. Motra kishte dalë të blinte diçka në shitore.



1.) Tregoni çka bëjnë të tjerët në shtëpi? Shkruani përgjigjet e plota.

1. Çka bën motra? _____

2. Çka bëjnë nëna dhe babai? _____

3. Çka bën vëllai i madh? _____

4. Çka bën vëllai i vogël? _____

5. Çka bëjnë gjyshi dhe gjyshja? _____

6. Çka bëjnë tezja dhe daja? _____

7. Ku banon e tërë familja? _____

8. Ku banon ti? _____

9. Me kë banon? _____

10. Çfarë fqinjësh keni? _____

2.) Shkruaj: Çfarë detyrash ke ti në shtëpi, si e ndihmon nënën dhe babanë?
Çka të pëlqen tëndihmosh, cilat detyrat nuk i doti? _____



Banesa jonë

Një pasdite Teuta i telefonoi shoqes së saj Valbonës.

- Mirëdita, Valbonë!
- Mirëdita, Teutë, - u përgjigj ajo.
- Dëshiroj të të tregoj se unë tash kam një adresë të re, - tha ajo.
- Aha a keni ndërruar banesën? – pyeti Valbona.
- Po, ne kemi marrë me qira një banese katërdhomëshe, - i tha Teuta e gëzuar.
- Unë tash kam një dhomë vetëm për vete. Edhe vëllai im e ka një dhomë për vete e po ashtu babi e mami. Kemi edhe një dhomë të pritjes, një kuzhinë dhe një banjë.
- A ka vend të lojërave në oborr? – pyeti Valbona.
- Po, para ndërtësës është një vend i lojërave. Kur të vijsh tek unë do të dalim të luajmë.
- Në cilin kat është banesa? – pyeti ajo.
- Ne jemi në katin e katërt, - tha Teuta.
- Faleminderit për thirrjen, Teutë. Unë do të vij të shtunën te ti.
- Mire se vjen. Gëzohem shumë që do të shoh ty, - i tha ajo e gëzuar dhe shkoi në dhomën e saj të rregullonte librat.
- Kur të vijë Valbona gjithçka do të jetë e rregulluar, - tha ajo më vete e lumtur.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

qiraja - pagesa mujore për banesën që e marrin në shfrytëzim
për një kohë të caktuar

kati - secila nga pjesët e një ndërtese që ngrihen njëra mbi tjeterën

1.) Përgjigju pyetjeve

1. Kujt i telefonoi Teuta?
2. Çfarë lajmi të ri i dha Teuta shoqes së saj?
3. Sa e madhe është banesa e Teutës?
4. Çfarë ka para ndërtesës ku banon tash Teuta?
5. Kur do te vijë Valbona te vizitojë shoqen e saj?

2.) Përkthe në gjuhën e vendit ku t'i jeton këto fjalë:

banesa _____ gëzohem _____

qiraja _____ e/i lumtur _____

vendi i lojërave _____ kati _____

3.) Përshkruaje banesën tënde

Unë banoj në (ku?) _____

Banesa ime është (sa dhoma ka?) _____

Ajo ka (përpos dhomave çfarë pjesësh të tjera ka?) _____

4.) Vizato banesën tënde brenda katërkëndëshit, bëje një plan ose vizato dhomën tënde të preferuar



Shkolla jonë

Unë jam në klasën e dytë. Shkolla ime quhet Shkolla fillore "Vellezërit Grimm". Në të ka shumë nxënës nga disa shtete të botës. Ajo gjendet në qendër të qytetit dhe ka dy kate. Çdo kat ka nga 6 dhoma mësimi me dritare të mëdha, banka e karrige të reja e të pastra e kompjuterë.

Në katin e parë është dhoma e mësuesve, zyra e drejtoreshës dhe zyra e sekretares. Në hyrje të shkollës është edhe dhoma e shtëpiakut, i cili kujdeset për shkollën. Në fund të oborrit të shkollës, që është i rregulluar mirë e i mbushur me lule e gjelbërim gjendet salla e madhe sportit, ku i mbajmë orët e edukatës fizike.

Të gjithë kujdesemi që shkolla jonë të jetë e pastër dhe e rregulluar mirë.

SHKOLLA IME

Sa me qejf që shkoj,
unë në shkollën time,
mësuesin e dëgjoj,
kur na jep mësime.

Kur shkoj në shtëpi,
mbushem me gëzime,
por mendja më rri,
mu te shkolla ime.

1.) Mësojeni vjershën përmendsh!

2.) Përkthe në gjuhën e vendit ku jeton këto fjalë:

qendra e qytetit _____ dhoma e mësimit _____

dhoma e mësuesve _____ sekretarja _____

shtëpiaku _____ pastruesja _____

3.) Plotësoni vijat me emrat që i përshtaten fjalisë

1. _____ kujdeset për mirëvajtjen e mësimit.
2. _____ mësojnë dhe edukojnë nxënësit.
3. _____ lëshon vërtetime e përgjigjet në telefon.
4. _____ kujdeset për shkollën.
5. _____ pastrojnë klasat dhe dhomat e tjera të shkollës.

4.) Lidhni me shigjetë pjesët e fjalisë.

- | | |
|------------------------|---------------------------------|
| 1. Drejtori | në pushim shpërndan qumësht. |
| 2. Shtëpiaku | kujdeset për punën në shkollë. |
| 3. Sekretarja | bisedojnë në dhomën e mësuesve. |
| 4. Pastruesit/et | luajnë në oborrin e shkollës. |
| 5. Nxënëset e nxënësit | përgjigjet në telefon. |
| 6. Mësueset e mësuesit | pas mësimit pastrojnë shkollën. |

Kush tjetër punon në shkollën tuaj? _____

5.) Sikur të isha mësues/e

Shkruar çka do të bëje ndryshe, si do ta bëje mësimin.

Ne klasën e shkollës shqipe

Besa shkon me qejf në shkollën shqipe të mërkurën pasdite. Klasa ku ajo mëson është e veçantë. Aty ka nxënës të vegjël e të mëdhenj. Djemtë e vajzat janë nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Presheva e dy nxënës janë nga Mali i Zi.

Një ditë mësuese Zana kishte sjellë në klasë një hartë të madhe ku shiheshin vendet ku jetojnë shqiptarët. Ajo u tha atyre të vendosnin emrat e tyre në pjesën e hartës prej nga është familja e tyre. Të gjithë nxënësit filluan të punonin. Pastaj secili nxënës paraqiti disa të dhëna për qytetin a fshatin e origjinës. Në fund mësuesja u tregoi atyre një reportazh televiziv me pamje nga trojet shqiptare. Fëmijët u kënaqën shumë me bukuritë e atdheut të tyre.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

me qejf - kur bën diçka me déshirë

vendi i origjinës - vendi prej nga vjen familja



Burhan Ahmeti - *Teknikë e kombinuar*

1) Bëni një listë të komunave në Kosovë, Maqedoni etj. nga vijnë familjet tuaja, shikoni në hartë se ku gjenden ato komuna!

2) Në vend të vijave vendsosni fjalët: tryezë, klasë, karrigia, grup, çantat. Nxënësit mësojnë së bashku në _____. Ata punojnë në _____.

Të gjithë janë ulur në _____ dhe qëndrojnë rrëth _____.

Kohë pas kohe ata ngrihen për të sjellë mjetet e punës nga _____ e veta, si dhe: lapsin, gomën, vizoren, gërshërët, mprehësen e lapsave, ngjyrat, dritaren.

Korabi sjell një _____ për të mpreh lapsin.

Arta nxjerr një palë _____ për ta prerë letrën.

Çlirimi mpreh _____ e drurit për të ngjyrosur më mirë.

Valbona bënë viajë të drejta me _____.

Trimi fshin gabimet me _____.

Valmira shkruan në _____ për punën e secilit nxënës.

Mësuesja hap _____ për të ajrosur klasën.

3) Shkruaj diçka për fshatin a qytetin prej nga është familja jote

Shtatë motrat

Një natë gjyshi na tha: Sonte do t'ju tregoj disa gjëegjëza. Dëgjoni, tha gjyshi, dhe filloi.

Porsi motra rrojmë bashkë, jemi plot tridhjetë e gjashtë, që të gjitha emër kemi, a e dini cilat jemi?

Ende pa mbaruar mirë gjyshi gjëegjëzën,
ia prita: gjysh!
- Shumë mirë, -tha gjyshi. Tani dëgjoni tjetrën.

Shtatë motra venë e vijnë, njëra tjetrën s'e arrijnë.

Motra u ngut dhe tha: Këto janë. dhe filloi t'i thotë:



Gazmend Leka:
Gjergj Elez Alia

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

gjëegjëza	- pyetje e komplikuar (e vështirë) për diçka, ku duhet të mendohet shumë për të gjetur përgjigjen
ia prita	- i thashë
venë e vijnë	- shkojnë e kthehen

Ja edhe disa gjëegjëza që mund t'i zgjidhni me ndihmën e mësuesit/ mësueses.

Kush më thotë nga ju fëmijë, eshtë një vend plot begati. Për të zemra rräh me mall, për të punon sa je gjallë.

Zgjohet herët në mëngjes, ia nis punës me kënaqësi lule më lule pa përtesë, të bëjnë mjaltë për fëmijë.

Kur zbardh dita shkojnë e bien kur vjen nata, të gjithë ngrihen; të mëdhenj janë pa kufi t'vegjël duken si shkëndi'.

Mendje s'ka, por të mëson. Çka, me ty flet, kur për ditë me të jeton, mik të ngushtë e ke për jetë.

T'i shtojmë njohuritë

- Katër javë bëjnë një muaj.
- Tre muaj bëjnë një stinë.
- Katër stinë bëjnë një vit.
- Viti ka dymbëdhjetë muaj.

1.) Përgjigjuni këtyre pyetjeve:

1. Cila ditë është sot? _____
2. Cila ditë do të jetë nesër? _____
3. Po pasnesër cila ditë do të jetë? _____
4. Cila ditë ishte dje? _____
5. Po pardje cila ditë ishte? _____
6. Cilat ditë janë ditë pushimi? _____

Ditët e javës

- | | | |
|--|--|---|
| 1. Herët në mëngjes,
java Ben fillon,
ditë e parë e saj
çdoherë është e hënë. | 2. Motra si mësuese
vazhdon me Benin:
ditë e dytë e javës
e martë e ka emrin. | 3. Mos e harro kurrë,
vërja veshin fjalës,
quhet e mërkurë
ditë e tretë e javës. |
| 4. Edhe ditë e katërt,
radhën s'e gabon,
si çdo ditë ka emër,
e enjte i thonë. | 5. Pastaj ditë e pestë,
Beni, më kuption?
e premte me "p"
si pata fillon. | 6. Shkon dhe kjo ditë,
e gjashta pason,
e shtunë e quajnë,
java sa s'mbaron. |
| 7. Ditë e shtatë erdhi,
Ben, dritë, o zemër,
quhet ditë e diel,
nuk ka tjetër emër. | | |

AVNI DEHARI

2.) Mësojeni nga një strofë dhe luani në klasë apo edhe në festa shkollore!



Unë u ndihmoj prindërve

Një ditë, posa u ktheva nga shkolla, nëna më tha:

- Bija e nënës, shko dhe më bli një bukë, një kilogram sheqer, makarona, një kilogram domate dhe dy litra qumësh.

Mora të hollat nga nëna dhe u nisa për në shitore. Së pari shkova në furre dhe e bleva bukën. Pastaj shkova në shitoren e gjérave ushqimore, ku bleva një kg. sheqer dhe makaronat. Pasi i pagova në arkë, u nisa për në shitoren e pemëve dhe të perimeve. Aty bleva domatet dhe pastaj shkova në librari për të blerë dy fletore për vete. I bleva edhe ato dhe u ktheva në shtëpi.

Të kuptojmë fjalët dhe shprehjet

gjëra - sende

të holla - para

arkë - vendi ku bëhet pagesa

1) Përgjigjuni këtyre pyetjeve:

- Çfarë duhej të blinte vajza?
- Ku bleu bukën?
- Ku bleu sheqer e makarona?
- Në cilën shitore bleu domatet?
- Po ku bleu fletoret për vete?

Të shtojmë njohuritë:

- Ëmbëlsirat i blejmë në ëmbëltore
- Prodhimet e qumëshit i blejmë në bulmetore
- Mobiliet i blejmë në shitoren e mobilieve

Ushqimore

Pemë – perime

Bulmetore

Librari

1. Shkruaj emrat e ushqimeve sipas llojit të shitoreve.

patate
djathë
dardha
miell

bukë
fletore
gjalpjë
gjizë

qumësht
mollë
laps
gomë

rrush
oriz
domate
vaj

sheqer
speca
kripë

ngjyra
makarona
kos

2. Fjalitë e mëposhtme shkruani në vendin e duhur.

Mirëdita! Urdhëroni, çfarë dëshironi? Një kg. domate, ju lutem. Urdhëroni domatet. Edhe diçka tjetër? Ju lutem, edhe një kg portokaj. Urdhëroni portokajtë. Faleminderit. Sa kushtojnë, ju lutem? Gjithsej 6,20 Euro. Urdhëroni paratë! Faleminderit. Ditën e mirë! Mirupafshim!

Blerësi

Shitësi

3. Shkruaj në cilat dyqane i blini ushqimet etj. në vendin ku jeton ti?

Urime Viti i Ri!



Festat e fundvitit

Po afrohen festat e fundvitit. Festa e Krishtlindjes është më 24 dhjetor. Pastaj është festa e Vtit të Ri.

Për Krishtlindje Iliri është ftuar tek Andi, shoku i klasës. Ai është kureshtar të shohë se si feston familja e Andit.

Familja e Ilirit e feston Vitin e Ri. Për natën e Vtit të Ri tek ata vijnë daja dhe një kushëri i babait. Fëmijët do të kënaqen duke luajtur. Iliri shpreson që prindërit do t'i dhurojnë një lojë interesante që quhet „Monopoly“.

Por më së bukuri është kur bëhet ndërrimi i viteve. Atëherë ata fillojnë të ndezin fishekzjarre. Qielli ndriçohet me lloj-lloj ngjyrash. Tërë qyteti është i zgjuar. Njerëzit e përqafojnë njëri-tjetrin dhe urojnë:

- Gëzuar Vitin e Ri! Shëndet, fat e lumturi!

Pastaj të gjithë vallëzojnë së bashku deri në orët e para të mëngjesit.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

Krishtlindje - festë e të krishterëve, Këershëndella

Viti i Ri - festa e ndërrimit të viteve

kureshtar - ai që ka dëshirë e madhe për të parë diçka, për të mësuar ndonjë fshehtësi

dhuroj - i jap dikujt diçka

fishekzjarr - fishek i mbushur me barut, që zbrazet në ajër me ngjyra të ndryshme

1.) Mësojeni këtë këngë

Mirë se vjen, o Vit i Ri

Ora dymbëdhjetë ra.

“Erdha!” Vit i Ri na tha.

Puthje, përqafime dhe urime plot
Është mbushur bota sot.

Mirë se vjen, o Vit i Ri,

Mirë se vjen në çdo shtëpi-

Paqe, lule, këngë dhe gëzim kudo
Nga ti, zemra jonë do.

(K. Mullaiu)

2.) Përgjigju pyetjeve

Për cilën festë e ftoi Andi Ilirin? _____

Cilën festë e feston familja e Ilirit? _____

Çfarë ndezin ata kur bëhet ndërrimi i viteve? _____

Si e urojnë ata njëri-tjetrin? _____

3.) Përkthe në gjuhën e vendit ku mëson këto fjalë

Viti i Ri _____ dhuratë _____

gëzuar _____ fishekzjarr _____

4.) Plotëso tekstin

Vitin e Ri unë do ta festoj _____.
Unë do t'i shkruaj një kartolinë _____.
Në vitin që vjen unë dëshiroj që _____

5.) Çfarë festash festoni ju në shtëpinë tuaj dhe si i festoni?

Shkruaj! _____

6.) Shkruaj një shoku/ një shoqeje një kartolinë

Fillo me fjalët

I dashur/ E dashur _____

Të uroj _____

Të dëshiroj _____

Përfundo me një përshëndetje: _____



Ditëlindja

Zana dhe Eva janë shoqe.
Elona, shoqja e klasës i ka ftuar në ditëlindje.
Zana dhe Eva i blenë një libër për dhuratë.
Kur arritën tek Elona, i gjetën edhe shokët e tjerë:
Albanin, Denisin, Drinin dhe Arditin.
Të gjithë shokët e shoqet i uruan:
Gëzuar ditëlindjen, Elona!
Nëna e Elonës solli një tortë me 9 qirinj.
Fëmijët kënduan këngën e ditëlindjes.
Luajtën e kënduan deri në mbrëmje.

Gëzuar ditëlindjen

Vogëlushja jonë Elonë,
ditëlindjen sot feston.
Vijnë shokët, shoqet vijnë,
mbushin plot me gaz shtëpinë.
Në një gojë, gjithë thonë:
“ Njëqind vjeç u bëfsh, Elonë!”

Detyrë:

Mësojeni këtë vjershë përmendsh!

1.) Përgjigju me gojë e pastaj edhe me shkrim këtyre pyetjeve:

- Kush feston ditëlindjen? _____
- Sa vjet i mbushte Elona? _____
- Kë kishte ftuar Elona në ditëlindje? _____
- Çka i dhuruan Elonës Zana dhe Eva. _____
- Çka u solli nëna e Elonës? _____
- Cilën këngë e kënduan shokët dhe shoqet? _____
- Me cilat fjalë ia uruan ditëlindjen Elonës? _____
 - a) _____
 - b) _____

2.) Shkruaj!

1. Kur e ke ti ditëlindjen? _____
2. Ku ke lindur? _____
3. Cilët shokë e shoqe do t'i ftosh në ditëlindjen tënde? _____

4. Çfarë dhuratash dëshiron për ditëlindje? _____

5. Ku dëshiron të shkosh me shokët/shoqet për ditëlindjen tënde?

a) në kinema b) në Mc Donald's c) në ëmbëltore

3.) Vizato çka dëshiron më së shumti për ditëlindjen e ardhshme



Kërkimi i faljes

Pas një grindjeje të vogël, Besmiri iu drejtua Anës:

- Ti je një thes me dhjamë!

Ai e pa që Ana u skuq nga inati, prandaj vazhdoi ta përqeshte edhe më tutje.

- Mos më fyej ashtu, - i tha ajo e zemëruar.

- Pse, çka mund të më bësh ti mua? Asgjë! - tha Besmiri duke u krekosur para Anës.

Në atë moment erdhi mësuesi i shkollës shqipe.

- Çka ka ndodhur?, - pyeti ai.

- Besmiri më ka sharë, - tha Ana gati duke qarë.

Mësuesi iu drejtua Besmirit.

- Përse e ke fyer Anën?

- Ana më ka sharë e para, - tha Besmiri.

- Besmir, Ana thotë se ti e ke fyer atë, - tha mësuesi.

- Unë kam dashur të bëj pak shaka, - tha Besmiri i penduar.

- Besmir, ti e di që ne kemi vendosur rregullat për bashkëjetesën në shkollë. Tash kërkoji falje Anës. Pastaj do të shkruash një faqe të fletores me rregullën numër katër.

Besmiri u ul në vend dhe nxori fletoren të shkruante rregullën, të cilën nuk e kishte respektuar.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

grindje - zënëkë me fjalë mes njerëzve

përqesh - e tall dikë me fjalë e gjeste

fyej - shaj dikë me fjalë të rënda

krekosem - mburrem e shes mend, nxjerr trupin përparrë

shaka - fjalë që thuhen për të qeshur dikë a diçka

bashkëjetesë - të jetuarit së bashku në klasë a diku tjetër

1.) Përgjigju pyetjeve

Çfarë i tha Besmiri Anës? _____

Si iu përgjigj Ana? _____

Kush erdhi aty? _____

Si u arsyetua Besmiri? _____

Çfarë i tha mësuesi Besmirit? _____

2.) Përkthe në gjuhën e vendit ku mëson këto fjalë

përqesh _____ fyej _____

bashkëjetesë _____ shaj _____

3.) Pyete shokun/shoqen e bankës se çka bën ai/ajo kur dikush e përqesh?

Shkruaj mendimet që thotë ai/ajo. _____

4.) A të ka fyer njëherë dikush rëndë?

Përshkruaj këtë përvojë dhe si e ndjeve veten. _____

5.) Shkruaj dy rregullat për bashkëjetesën në klasë që sipas teje janë më të rëndësishmet _____



Vajzat luajnë futboll

Një ditë djemtë dolën të luanin futboll. Me ta ishin dhe katër vajza të klasës. Edhe ato dëshironin të luanin. Por Mentor nuk donte që ato të luanin me djemtë.

- Ju nuk jeni për lojën e futbollit, - tha ai.
- Pse nuk jemi, ne luajmë mirë, - tha Drita.
- Ju lëndoheni lehtë, pastaj ankoheni që ne ju shtyjmë, - ia ktheu Fatosi.
- Unë mendoj që ato mund të luajnë me ne, - tha Tomori, - Edhe ashtu ne jemi pak.

Vetëm duhet të luajmë me kujdes, - tha Beni.

Pas pak loja filloi.

Pas disa minutash lojë, Arta dha një gol.

- Urraaa! - thirri Gazmendi, ky ishte një gol i bukur!

Loja vazhdoi me shumë shpejtësi. Po afrohej koha kur duhej të hynin në klasë. Rezultati mbeti i barabartë. Duke dalë nga fusha Mentor tha:

- Do të vazhdojmë të luajmë pasdite, - dhe ngjiti shkallët e shkollës.



1.) Përgjigju pyetjeve:

1. Çfarë donin të bënин fëmijët? _____
2. Pse Fatosi nuk donte që edhe vajzat të luanin? _____
3. Cila vajzë e dha një gol? _____
4. Si përfundoi loja? _____

2.) Çka mendon: A është futballi për vajza? Pse më shumë po apo më shumë jo?

3.) A të kanë përjashtuar ty një herë nga loja sepse je vajzë/djalë? _____

4.) Ngjyros topin e futbollit



5.) Plotëso fjalitë

Loja që më pëlqen mua është _____

Lojtari që më pëlqen quhet _____

Unë jam simpatizues i ekipit _____

6.) Shkruaj disa fjali përmënyrën si luhet një lojë që e do _____

Qetësi

(Pjesë teatrale)

Zana: – Mimbrëma, Beni.

Beni (hesht)

Zana (përsërit): – Beni!

Beni (flet me zë të ashpër): – E, moj, ç'do?

Zana: – Mirëmbrëma, të thashë.

Beni: – Mirë, e dëgjova. E pastaj, ç'do nga unë?

Zana: – Dua të jesh më i sjellshëm.

Beni (me ironi): – Ashtu ë? U hidhërove ti se nuk t'u përgjigja, ë?

Po ti mendon se tregohesh e sjellshme kur nuk respekton të tjerët? A nuk sheh se unë po mësoj ?

Zana: – Po unë s'të pengova të mësosh, vetëm të përshëndeta.

Dhe ti duhet të ma kthesht përshëndetjen.

Beni: – E, mirë, lërmë rehat tash, se kam një mësim të vështirë.

Zana: – Të gjithë kemi mësime të vështira. Sot na dha mësuesja një mësim të ri në aritmetikë, që nuk e marr vesh fare. Do të më ndihmosh pak?

Beni (hesht)

Zana (e tund nga supet): – E, ore, ty të flas!

Beni (duke pasur mendjen te libri): – Mirë, mirë. Më lër të mbaroj.

Zana: – Mirë, por mbaro shpejt! (Fillon të këndoje një këngë, por ndalat që në notat e para. E kuption edhe vetë).

Ah, nuk e nisa mirë! Ben, aman ma kujto pakëz këtë këngë! E mësuam sot. Është këngë e bukur, por s'po më kujtohet.

Beni: – Moj, a nuk e sheh se po mësoj? Ngenë e këngëve të tua kam tash?

Zana: – Por edhe unë për mësim e kam këtë këngë! Sa egoist që je!

Vetëm për vete mendon.

Beni: – Zana! Të lutem, mbylle...! Kam një mësim të vështirë, të them edhe një herë.

Zana: – Edhe unë po ta përsëris. Je egoist. Do tjetër tash?

Beni: – Dua qetësi!

Zana: – Mirë, mirë, po dal jashtë dhe s'po bëj asnjë mësim. Ti do ta marrësh përsipër fajin për mësimet e mia nesër.

(Duke dalë para shikuesve) S'ka faj ky. E ka përkëdhelur babai.

Djali im është i shkëlqyer, thotë. Kurse kjo (bën me gisht nga vetja) e ka mendjen te lodrat. Si thoni? Ç'faj kam unë?

Adelina Mamaqi

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet

hesht - nuk flet

flet me të ashpër - me zë të lartë

me ironi - me tallje

aritmetikë - matematikë

e tund nga supet - e kap për supe

aman - të lutem

ngeja - koha e lirë

egoist - njeri që mendon vetëm për vete

e ka përkëdhelur - e ka lazduar,

zënkë - grindje

I shkruani në gjuhën e vendit

1.) Si mendoni ju për këtë zënkë në mes motrës dhe vëllait?

Bisedoni me njëri-tjetrin.

Kujt i jepni të drejtë? _____

Ç'faj ka Beni? _____

Po Zana ç'faj ka? _____

2.) Lexojeni tekstin me role të ndryshme e pastaj mësoni ta luani si pjesë teatrale në klasë dhe në festa shkollore.

3.) Trego edhe ti ndonjë ngjarje të tillë (grindje) me vëllain, motrën apo me shoqen e shokun.

Përshkruaj a) çka ka ndodhur, b) si e ke zgjidhur atë problem, c) kush të ka ndihmuar ta zgjidhë problemin? _____



Shoqja ime Stela

Një ditë, pas mësimit u nisa për në banesë. Kur arrita para pallatit, e gjeta shoqen time, Stelën, duke qarë. Më të shpejtë iu afrova dhe e pyeta:

- Ç'të ka ndodhur, Stela?

- Nora, nuk mund të hyj brenda, se i paskam harruar çelësat në banesë, e prindërit janë në punë, - u përgjigj ajo.

E qetësova Stelën dhe e ftova të vinte tek unë. U gëzua, nxori një copë letër në tē cilën shkroi: Të dashur prindër, jam te Nora. Kur tē ktheheni më kërkoni atje! Stela.

Letrën e vari në derën e banesës. Pasi hëngrëm drekë bashkë dhe mbaruan detyrat shtëpiake, Stelën erdhi ta merrte nëna e vet. Ajo u falënderua dhe tha: „Vërtet, ju shqiptarët jeni shumë mikpritës“.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

para pallatit - para ndërtuesës

e qetësova - i hoqa mërzinë, frikën

e ftova - e thirra

mikpritës - pritje e mirë e shokut, e mikut

1.) Bashkëbisedoni:

Njëri nxënës pyet, tjetri përgjigjet. Pastaj i shkruani përgjigjet në fletore.

- Çka janë Nora dhe Stela?
- Pse Stela nuk mund të hynte në banesë?
- Çfarë bëri Nora?
- Çka ngjiti Stela në derën e banesës së vet.
- Çfarë bënë ato në banesë?
- Kush erdhi ta merrte Stelën?
- Çka i tha ajo nënës së Norës?

2.) Radhitni fjalitë sipas rrjedhës logjike të tregimit duke shkruar numrin përpara

- _____ E qetësova Stelën dhe e ftova të vinte tek unë.
- _____ Kur arrita para pallatit e gjeta shoqen time Stelën duke qarë.
- _____ Pasi hëngrëm drekë bashkë dhe mbaruam detyrat shtëpiake,
Stelën erdhi ta merrte nëna e vet.
- _____ “Nora, nuk mund të hyj brenda, se i paskam harruar çelësat
në banesë”.

3.) T'i shtojmë njohuritë:

Pyetni prindërit ose mësuesin se cili zakon pos mikpritjes është i njohur tek shqiptarët?

4.) A ke përjetuar ndonjëherë diçka të ngjashme me aventurën e Stelës?

Shkruaj! _____

5.) Shkruaj letrën e Stelës në gjuhën e vendit ku jeton _____



Mes dy vendeve

Një pasdarke Elza e pyeti babanë:

- Pse kemi ardhur në Zvicër?
- Eh, bija ime, - tha ai dhe shikoi nga dritarja, – kur unë erdha këtu, në Kosovë nuk kishte punë. Nuk kishte liri. Për t'ju ushqyer juve u detyrova të vija këtu.
- Çka është liria? - e pyeti ajo.
- Kjo është një fjalë që ka kuptim të gjerë. Por kur nuk ke liri, do të thotë nuk je i lirë, nuk je zot në shtëpinë tënde, - tha ai.
- Por tash Kosova është e lirë, - tha Elza.
- Po, - tha babai, - por ende ka vështirësi. Shumë njerëz nuk kanë punë.
- Prandaj ne i ndihmojmë ata, - shtoi Elza.

Asaj iu kujtua që babai herë pas here u dërgonte para gjyshit e gjyshes në Kosovë.

- Po, bija ime, ata kanë ende nevojë për ndihmën tonë, - tha ai.

Elza i përqafoi fort babanë dhe nënën. Ajo ishte krenare me prindërit e saj.

T'i kuptojmë fjalët dhe shprehjet:

liria - gjendja kur një popull nuk është i pushtuar, jeton i lirë
krenare - kur e çmon veten si njeri, kur kënaqet me sukseset e të tjera

1.) Përgjigjuni pyetjeve

Çfarë e pyeti Elza babanë? _____

Pse kishte ardhur familja e Elzës në Zvicër? _____

Si është Kosova tash? _____

Kë e ndihmon familja e Elzës? _____

Pse krenohet Elza me prindërit e saj? _____

2.) Përkthe këto fjalë në gjuhën e vendit ku banon

liria _____ ndihmoj _____

kemi ardhur _____ dërgoj _____

3.) Plotëso tekstin e mëposhtëm

Unë me familjen time të ngushtë jetoj në _____

Unë kam lindur në _____

Familja ime vjen nga _____

Unë e dua shumë vendin tim, sepse _____

4.) Bëj një intervistë me një shok/shoqe të klasës. Shënoji në fletore përgjigjet e tij/e saj:

Si quhesh?

Prej nga është familja jote?

A ke lindur këtu apo në atdhe të prindërve të tu?

A shkon shpesh në atdhe?

Pse familja jote ka ardhur këtu?

Tregoji grupit tënd për të dhënat që i ke marrë nga shoku/shoqja.





Nexhat Maloku, Rifat Hamiti

UNË DHE TË TJERËT

Fletore tematike

Botimi i parë

Botues:

Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë

Për botuesin:

Agim Lluka

Redaktor teknik:

Lavdim Beqiri

Tirazhi: 5.000 kopje

Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010

në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë

www.dukagjinigroup.com

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

37: 811.18 (076.1)(075.2)

Maloku, Nexhat

Unë dhe të tjerët: fletore tematike: për nivelin e parë/

Nexhat maloku, Rifat Hamiti. - Botimi 1.-Pejë:

Dukagjini, 2010. - 48 f. ilustr. me ngjyra; 27 cm.

1. Hamiti, Rifat

ISBN: 978-9951-05-231-3

*Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 298/2, të datës 22.06.2010*